



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KONISPOL

DREJTORIA E BURIMEVE NJEREZORE

Nr.

.Prot

Konispol më

**RREGULLORE E BASHKISË KONISPOL PËR HETIMIN ADMINISTRATIV TË
KËRKESËS SË SINJALIZUESIT PËR MBROJTJEN NGA HAKMARRJA**

**Neni 1
Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në zbatim të ligjit nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve".

**Neni 2
Përkufizime**

Në këtë Rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- "Autoritet publik" ka të njëjtin kuptim me atë të dhënë në ligjin për të drejtën e informimit.
- "Hakmarrje" është çdo veprim, i drejtpërdrejtë ose jo i drejtpërdrejtë, ose kërcënim, i kryer nga

organizata, me natyrë diskriminuase, disiplinore ose që, në një formë tjetër të padrejtë, dëmton interesat e ligjshëm të sinjalizuesit dhe që rezulton nga sinjalizimi.

- "I sinjalizuar" janë një ose më shumë persona, ndaj të cilëve bëhet një sinjalizim, sipas këtij ligji, në lidhje me një veprim ose praktikë të dyshuar korruptive.

- "Bashkia Gjyrokastër" është Institucioni I Pushtetit Vendor

- "Mbrojtje" është mbrojtja e sinjalizuesit nga hakmarrja, sipas mekanizimit të përcaktuar në kreu V të ligjit nr.60/2016.

- "Njësia përgjegjëse" është organi i posaçëm, i caktuar brenda autoritetit publik ose subjektit privat, i përbërë nga një ose më shumë punonjës të organizatës dhe i ngarkuar me detyrën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe shqyrtimin e kërkesës për mbrojtjen e sinjalizuesit.

- "Organizatë" është autoriteti publik ose subjekti privat.

- "Sinjalizim" është raportimi i informacionit nga ana e sinjalizuesit të njësia përgjegjëse për veprime apo praktika të dyshuara korruptive, të kryera në vendin e tij të punës në autoritetin publik apo subjektin privat.

- "Sinjalizues" është individ, i cili aplikon ose është në marrëdhënie pune, ose ka punuar më parë pranë autoritetit publik apo subjektit privat, pavarësisht nga natyra e marrëdhënies së punës ose kohëzgjatjes së saj, si dhe nëse paguhet ose jo, që sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korruptive.

- "Subjekt privat" është personi juridik privat, sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, përfshirë tregtarin, sipas ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

- "Veprim ose praktikë e dyshuar korruptive" është një veprim ose mosveprim, fakte ose rrethana të kryera në një organizatë, për të cilat sinjalizuesi dyshon në mirëbesim, sipas këtij ligji, se mund të përbëjë korruption.

Neni 3

Kryerja e veprimeve procedurale

1 Veprimet procedurale të Njesisel-së Sinjalizuese kryhen në përputhje me ligjin nr. 60/2016 dhe në rast të mosparashikimit nga ky ligj sipas Kodit të Procedurave Administrative.

2. Njoftimet për veprimet procedurale, për të cilat Njësia cakton afate, duhet të përmbajnë paralajmërimin e shprehur mbi pasojat e mosrespektimit të afatit.

Neni 4 Mbrojtja kundër hakmarrjes

1. Sinjalizuesi, i cili sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korruptive, sipas ligjit nr. 60/2016, mbrohet ndaj çdo mase hakmarrëse të marrë ndaj tij nga organizata, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

- a) shkarkimin nga puna;
- b) pezullimin nga puna ose të një ose më shumë detyrave;
- c) transferimin brenda ose jashtë organizatës;
- ç) uljen në detyrë;
- d) uljen e pagës dhe/ose të shpërblimeve financiare;
- dh) humbjen e statusit dhe të privilegjeve;
- e) mosngritjen në detyrë;
- ë) heqjen e së drejtës për të marrë pjesë në trajnime;
- f) vlerësime negative në marrëdhënien e punës;
- g) forma të tjera të hakmarrjes në lidhje me punën.

2. Çdo akt i hakmarrjes ndaj sinjalizuesit është i pavlefshëm.

3. Nëse sinjalizuesi dëshiron të vendoset në një strukturë tjetër të organizatës, për të mbrojtur veten nga reagime armiqësore në mjedisin e tij të afërt të punës, paraqet kërkesë me shkrim tek drejtuesi i organizatës dhe një kopje e saj i dërgohet Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së.

4. Organizata merr masat e arsyeshme dhe të përshtatshme për të lehtësuar një lëvizje të tillë. Në rast të mos miratimit apo moskthimit të përgjigjes Brenda. 5 ditësh nga data e paraqitjes së saj, Njësia, me kërkesë të sinjalizuesit, menjëherë i drejtohet organit kompetent, sipas legjislativionit në fuqi, për të urdhëruar autoritetin publik të marrë të gjitha masat, sipas këtij neni.

5. Nëse organi kompetent nuk merr masat e kërkuara, Njësia i drejtohet me kërkesëpadi gjykatës kompetente.

Neni 5 Procedura e hetimit të kërkesës për mbrojtje

1. Sinjalizuesi, i cili pretendon se është subjekt i një akti hakmarrjeje, fillimisht duhet të paraqesë kërkesë për mbrojtje te njësia përgjegjëse e organizatës. Në ato organizata ku nuk ka njësi

përgjegjëse sinjalizuesi që pretendon se është subjekt i një akti hakmarrjeje i drejtohet drejtpërdrejt Njesisë.

2. Njësia përgjegjëse merr menjëherë masat dhe në çdo rast jo më vonë se 10 ditë nga paraqitja e kërkesës, vendos me akt të ndërmjetëm të arsyetuar për riparimin e pasojave të paligjshme nga akti i hakmarrjes. Në rast të shkeljes së këtij afati, kërkesa e sinjalizuesit paraqitet tek Njësia, që vendos brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës 3 për riparimin e pasojave të paligjshme të aktit të hakmarrjes.

3. Njësia, brenda 5 ditëve nga data e marrjes së një kërkesë për mbrojtje nga hakmarrja, njofton me shkrim sinjalizuesin për regjistrimin e pretendimit dhe emrin e personit pranë Njesisë, i cili do të ndjekë çështjen. Përmbajtja e regjistrit të posacëm për këtë qëllim përcaktohet me urdhër të vecantë të Inspektorit të Përgjithshëm.

Neni 6

Hetimi administrativ dhe barra e proves

1. Njësia heton administrativisht pretendimet për hakmarrje për të përcaktuar nëse ka shkaqe të arsyeshme për të besuar që ka ndodhur, është duke ndodhur ose prite të ndodhë një akt hakmarrjeje.

2. Njësia në hetimin administrativ i kërkon me shkresë organizatës të provojë që masat e marra në dëm të sinjalizuesit janë bazuar në shkaqe të ndryshme dhe që nuk lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me sinjalizimin. Organizata ka barrën e provës në këtë proces dhe i përgjigjet Njësia me shkrim brenda 10 ditësh nga data e marrjes së kërkesës.

Neni 7

Bashkëpunimi

1. Organizata dhe sinjalizuesi bashkëpunon me Njësinë në përcaktimin e fakteve dhe rrethanave të nevojshme për zgjidhjen e çështjes së aktit të hakmarrjes ndaj sinjalizuesit. Organizata është e detyruar të paraqitur informacione, prova, dokumente, deklarata apo për t'u paraqitur personalisht përpara Njesisë.

2. Organizata cdo deklarim apo argument të saj e paraqet me shkrim.

Neni 8

Mjetet e kërimit të proves

1 Gjatë hetimit administrative Njësia me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen mund:

- a) të mbledhë deklarata nga palët, dëshmitarët dhe ekspertët;
- b) të marrë dokumente dhe dokumente të tjera të dokumentuara nëpërmjet mjeteve fotografike, të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike;
- c) të vizitojë vende të caktuara.

2. Kur një provë, nga e cila varet zgjidhja e çështjes së aktit të hakmarrjes ose që ndikon në sqarimin e saj, ka rrezik të zhduket ose të vështirësohet ose bëhet e pamundur marrja e saj, Njësia kryesisht apo me kërkesën e sinjalizuesit, mund të vendosë marrjen më parë të kësaj prove (sigurimi i provës).
3. Njësia që zhvillon procedurën administrative mund të vendosë sigurimin e provës edhe përpara fillimit të procedurës administrative. Sigurimi i provës mund të bëhet edhe në çdo fazë të procedurës administrative. Përgjegjësia për sigurimin e provave bie mbi Njësinë.

Neni 9

Njoftimi i sinjalizuesit

1. Njësia njofton me shkrim sinjalizuesin brenda 10 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për statusin e hetimit administrativ të kërkesës për mbrojtje dhe për çdo veprim procedural të ndërmarrë.
2. Pavarësisht nga afatet e njoftimit, Njësia është e detyruar t'i përgjigjet çdo kërkesë për informacion me shkrim, paraqitur në çdo kohë nga sinjalizuesi në lidhje me kërkesën e tij.

Neni 10

Masat në përfundim të hetimit administrativ

1. Nëse në përfundim të hetimit administrativ rezulton se është kryer një akt hakmarrjeje ndaj sinjalizuesit nga autoriteti publik, Njësia me shkrim i drejtohet organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi, për të urdhëruar autoritetin publik për marrjen e të gjitha masave për riparimin e shkeljes së kryer. Inspektori i Përgjithshëm parashikon në shkresë edhe rekomandimin konkretë për llojin e masës që duhet të merret.
2. Nëse në përfundim të hetimit rezulton se është kryer një akt hakmarrjeje ndaj sinjalizuesit nga subjekti privat, Njësia urdhëron subjektin privat të marrë të gjitha masat për riparimin e shkeljes së kryer. Inspektori i Përgjithshëm parashikon në shkresë edhe rekomandimin konkretë për llojin e masës që duhet të merret.
3. Nëse organi kompetent ose subjekti privat nuk merr masat e kërkuara nga Njësia, kjo e fundit paraqet kërkesëpadi në gjykatën kompetente.

Neni 11

Afati i përfundimit të hetimit administrativ

Procedura e hetimit administrativ të kërkesës për mbrojtje nga hakmarrja përfundon sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast jo më vonë se 60 ditë nga data e regjistrimit të kërkesës.

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë.

NJËSIA PËRGJEGJËSE

KRYETARI I BASHKISË

SHUAIP BEQIRI